

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 328, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË VETËQEVERSJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË NJËSIVE TË VETËQEVERSIJES VENDORE””, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka si qëllim realizimin e indeksimit dhe rritjes së pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit, në zbatim të kompetencës së Këshillit të Ministrave për të miratuar masën e indeksimit dhe rritjet e pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi hartohet si pasojë e detyrimit ligjor që ka Këshilli i Ministrave për të miratuar masën e indeksimit dhe rritjet e pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi i paraqitur është hartuar në bazë të përcaktimeve të dhëna në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 8, ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, për zbatimin e kompetencës që ka Këshilli i Ministrave për të miratuar elementet e pagës bruto mujore të të punësuarve në institucionet e administratës publike dhe vlerat

për çdo element, si dhe masën e indeksimit të pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike.

Indeksi i pagave për vitin 2026 bazohet në indeksin e ndryshimit të çmimeve të konsumit, të deklaruar/shpallur nga qeveria shqiptare në masën 2.5% dhe do të realizohet për të gjithë nëpunësit/punonjësit në njësitë e vetëqeverisjes vendore, për vitin 2026, njëjtë si edhe për funksionarët/nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet e administratës publike.

Nëpërmjet këtij projektvendimi realizohet:

a) Indeksi në masën 2.5% i vlerave të kufijve të pagave mujore, për funksionarët e zgjedhur të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Ndryshimi në rritje i vlerave të pagave për këta funksionarë, si rezultat i indeksimit varion:

i) Për kufijtë minimalë, nga 3,925 lekë në muaj, në 6,700 lekë në muaj;

ii) Për kufijtë maksimalë, nga 4,625 lekë në muaj, në 7,969 lekë në muaj.

b) Indeksi në masën 2.5% i vlerave të kufijve minimalë të elementit të pagës “paga për pozicion”, për nëpunësit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ndryshimi në rritje i vlerave të pagave për këta nëpunës, si rezultat i indeksimit varion nga 1,000 lekë në muaj, për pozicionin “specialist”, klasa IV-4, në të gjitha bashkitë, si dhe në këshillin e qarkut, deri në 2,625 lekë në muaj për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, në Bashkinë e Tiranës.

c) Indeksi në masën 2.5% i vlerave të kufijve maksimalë të elementit të pagës “paga për pozicion”, për nëpunësit e klasave I-2, I-3, I-4, I-5, II-1 dhe II-2 në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ndryshimi në rritje i vlerave të pagave për këta nëpunës, si rezultat i indeksimit varion nga 3,525 lekë në muaj, në 5,425 lekë në muaj.

ç) Indeksi në masën 2,5% dhe një politikë e diferencuar e rritjes së pagave për kufijtë maksimalë të vlerës së elementit “pagë për pozicion” për nëpunësit e klasave III-1, III-2, III-3, IV-1, IV-2, IV-3 dhe IV-4 në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ndryshimi në rritje për këta nëpunës varion nga 4,000 lekë në muaj për klasat III-1, III-2 dhe III-3, në 5,000 lekë në muaj për klasat IV-1, IV-2, IV-3 dhe IV-4.

d) Indeksi dhe rritja e kufijve të pagave bazë të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore me 10,000 lekë në muaj (nga 40 000–47 000 lekë në muaj,

në 50 000 – 57 000 lekë në muaj), në të njëjtën masë si edhe rritja e pagave të punonjësve të tjerë mbështetës të administratës publike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të:

- nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin e ndonjë *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim propozohet nga ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, ka 4 pika dhe 8 lidhje bashkëlidhur, që propozojnë sa vijon:

Pika e parë: përcakton: (i) ndryshimin e kufijve të pagave bazë të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore; (ii) zëvendësimin e lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8, të vendimit aktual;

Pika e dytë: përcakton që vlerat e: a) kufijve maksimalë të elementit “Pagë për pozicion” për klasat III-1, III-2, III-3, IV-1, IV-2, IV-3 dhe IV-4, në lidhjet nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6 dhe nr. 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe politikës së rritjes së pagave; b) kufijve minimalë e maksimalë në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5%; c) kufijve minimalë e maksimalë të elementit “Pagë për pozicion” për klasat I-2, I-3, I-4, I-5, II-1 dhe II-2, në lidhjet nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6 dhe nr. 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5%.

Pika e tretë: përcakton përballimin e efekteve financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, që për vitin 2026, përballohen nga transfertat e akorduar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, miratuar në ligjin 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, si dhe nga të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore;

Pika e katërt: përcakton institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, që janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi janë të njësive të vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe është dakordësuar në fazën e përgatitjes së tij me përfaqësues të Ministrisë së Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, sipas llogaritjeve të ministrisë përgjegjëse për financat janë:

- rreth 60 milion lekë në muaj për punonjësit mbështetës;
- rreth 83 milionë lekë në muaj për të punësuarit e tjerë për efekt të rritjes së kufirit minimal të pagës.

Ky efekt, për vitin 2026, do të përballohet nga transferta e akorduar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, miratuar në ligjin 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, si dhe nga të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore.

PROPOZUESI
MINISTRI I SHTETIT
PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN
ADEA PIRDENI